

MASTERI PROFESIONAL MENAXHIM SHËNDETËSOR

Masteri në Menaxhim Shëndetësor synon të përgatisë profesionistë të organizatave të kujdesit shëndetësor me synim fuqizimin e kapaciteteve për menaxhim dhe administrim në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor. Programi i përgjigjet nevojës bashkëkohore të sistemit drejtues të institucioneve për një menaxhim efektiv të shërbimeve dhe burimeve të sistemit shëndetësor në një mjedis me kërkesa gjithnjë e më komplekse, si rritja e cilësisë së shërbimeve, menaxhimi më i mirë i burimeve njerëzore dhe financiare, përdorimi i teknologjive dhe sistemeve të informacionit shëndetësor, si dhe koordinimi më i mirë i kujdesit ndaj pacientëve.



Të dhëna bazë:

Viti i hapjes: 2017

Kohëzgjatja: 1 vit akademik

Forma e studimit: Me kohë të plotë

Kredite: 60 ECTS/1500 orë mësimore

Programi: 10 lëndë + Praktikë Profesionale+Temë Diplome

Pjesëmarrja ndër vite

Studentë	Të regjistruar	Të diplomuar
2017	30	20
2018	35	18
2019	24	18
2020	24	19
2021	30	24
2022	21	18
2023	19	19
2024	24	15
2025	18	...

Programi

1. Ekonomi shëndeti
2. Menaxhim shëndetësor
3. Statistikë
4. Financë dhe kontabilitet i kujdesit shëndetësor
5. Përcaktorët socialë dhe mjedisorë të shëndetit
6. Epidemiologji menaxheriale

Programi (vazhdim)

7. Menaxhim i sistemeve të informacionit në shëndetësi & monitorimi dhe vlerësimi
8. Liderhip dhe aftësi komunikimi
9. Organizim i sistemit shëndetësor
10. Menaxhim i burimeve njerëzore
11. Praktikë (100 orë)

Kontributi i HAP



Mbështeti hartimin e një kurrikule moderne për programin e masterit, duke mobilizuar ekspertizë vendore dhe ndërkombëtare.



Forcoi kapacitetet pedagogjike të stafit akademik përmes trajnimeve të specializuara.



Siguroi literaturë të plotë në gjuhën shqipe për të gjitha modulet, duke garantuar akses të barabartë për të gjithë studentët e programit.



Mbështeti zhvillimin e tezave studentore të orientuara drejt praktikës, në bashkëpunim me institucionet partnere të projektit HAP.



Përmirësoi infrastrukturën e mësimdhënies përmes pajisjeve IT dhe mjeteve didaktike për zhvillimin e procesit mësimor.



Mbështeti vlerësimin e jashtëm të programit, rezultatet e të cilit u përdorën nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Ekonomisë për riorganizimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Si ka ndikuar masteri në karrierën profesionale të studentëve:

- 33% janë ngritur në detyrë
- 52% mbajnë poste menaxheriale
- 79% raportojnë ndikim të dukshëm në aftësitë e tyre të punës

(shifra të vitit 2023)